

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 381 Rep.
Nr. 48 Kol.

PULLE TAKSE



Tirane, me 26.01.2001

KONTRATE SHITBLERJE
(Kuota ne shoqeri) E

Sot me date 26 .01.2001 , para meje Noteres se Dhomes se Noterise Tirane , Alida Stamo , ne zyren e ndodhur ne rrugen "Mine Peza" Pall.Nr.99 ne qytetin e Tiranës , u paraqiten personalisht palet :

PALA SHITESE :

1. Shoqeria "ALKO-IMPEKS" sh.p.k. , e regjistruar ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane , ne baze te vendimit te kesaj Gjykate Nr.8069 , date 18.02.1994 , me seli ne Tirane , me adrese ne Bulevardin "Zogu i pare" Pallati Alkoimpeksit , perfaqesuar nga Ortaku i vetem i shoqerise zoti **IMER ADEMI** , i biri i Ademit dhe Martes , i datelindjes 18.02.1957 , i identifikuar me certificate lindje nr.20/24 , madhor me zotesi te plote per te vepruar , i cili eshte ortak ne shoqerine "OTTO-AL" sh.p.k. me 40 % te kuotave.

2. Shoqeria OTTO TIEFBAU GmbH & Co. , person juridik ne baze te legjislacionit Gjerman , me seli ne Brakel , Driburger Strasse 49 , 33034 , Gjermani , perfaqesuar nga zoti **STEPHAN OTTO** , i datelindjes 23.04.1964 , i cili eshte ortak i vetem i kesaj shoqerie , i cili ndodhet aktualisht ne Shqiperi , Tirane, i identifikuar me pasaporte gjermane nr.5546054862 , shtetas gjerman , madhor me zotesi te plote per te vepruar , i cili eshte ortak ne shoqerine "OTTO-AL" sh.p.k. me 19% te kuotave , i cili nuk kupton gjuhen shqipe , ne prani te perkthyesit **KRESHNIK SINANAJ** , i njohur personalisht nga ana ime.

PALA BLERESE

1. ISUF BERBERI , i biri i Aranitit dhe Marcelles , lindur ne Vlore dhe me banim ne Tirane , rruga e Elbasanit Pall.Nr.1 shk.11 , i datelindjes 24.08.1969 , i identifikuar me pasaporte nr.0184875 , madhor me zotesi te plote per te vepruar , ortak i shoqerise "OTTO-AL" sh.p.k. njohur me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane nr.21020 date 12.03.1999.

ME OBJEKT : shitjen e kuotave ne shoqerine "OTTO-AL" sh.p.k. nga ortaket e kesaj shoqerie , ku shoqeria "ALKO-IMPEKS" sh.p.k. shet 40 % te kuotave te saj dhe shoqeria "OTTO TIEFBAU GmbH & Co." shet 19 % te kuotave te saj , mbeshtetur ne vendimin e Asamblese se Ortakeve , nr.376rep dhe nr.44 kol date 25.01.2001 , te vertetuara nga une noterja , **ALIDA STAMO**.

CMIMI I SHITJES : 59.000 Leke (Pesedhjete e nente mije) leke , te ndare si me poshte :

-Shoqeria "ALKO-IMPEKS" sh.p.k. , me cmim 40 000 (dyzet mije) leke

-Shoqeria "OTTO TIEFBAU GmbH&Co." , me cmim 19 000 (nentembedhjete mije) lek

Palet kontraktuese me marreveshje midis tyre , me deshiren e tyre te lire , kerkuan nga une Noterja , redaktimin e Kontrates se shitblerjes se kuotave te mesiperme , mbeshtetur ne Vendimin e mbledhjes se Asamblese se Shoqerise "OTTO-AL" sh.p.k. me kushtet si me poshte vijon :

Shitesat , Shoqeria "ALKO-IMPEKS" sh.p.k. , shet 40 % te kuotave dhe shoqeria "OTTO TIEFBAU GmbH&Co." shet 19% te kuotave me te cilat ata jane ortake ne shoqerine "OTTO-AL" sh.p.k. , te cilat te dyja se bashku , zoterojne 59 % te kuotave sipas vendimit te Gjykates se Rrethit nr.21020/1 date 5.08.1999.

Shitesat deklarojne se me vullnetin e tyre te lire kuotat prej 59 % qe zoterojne ne shoqerine "OTTO-AL" sh.p.k. , ne baze te Vendimit te mbledhjes se Asamblese, ja shesin

Zotit ISUF BERBERI, i cili eshte ortak i kesaj shoqerise "OTTO-AL" sh.p.k., ku seicilit prej shitesave i blen kuotat si me poshte:

-Shoqerise "ALKO-IMPEKS" sh.p.k., i blen 40% te kuotave me cmimin 40 000 (Dyzete mije)leke dhe

-Shoqerise "OTTO TIEFBAU GmbH Co.", i blen 19 % te kuotave me cmim 19 000 (nentembedhjet mije) Leke,

ku gjithsej i blen kundrejt cmimit 59 000 (pesedhjet mije) leke, shuma te cilat sipas deklarimit te bere nga pala shitese, jane paguar plotesisht nga ana e bleresit jashte kesaj zyre noteriale.

Bleresi ISUF BERBERI, deklaron se ne baze te vendimit te mbledhjes se ortakeve te pershkruar me siper, ka blere kuotat e shitesave te:

Shoqerise "ALKO-IMPEKS" sh.p.k. 40% te kuotave me cmimin 40 000 (dyzetemije) leke, dhe

Shoqerise "OTTO TIEFBAU GmbH & Co.", 19% te kuotave me cmimin 19 000 (nentembedhjetemije) leke,

te cilat kane qene ortake te shoqerise "OTTO-AL" sh.p.k., shume e cila eshte paguar plotesisht nga bleresi, jashte kesaj zyre noteriale.

Keshtu, me firmosjen e kesaj kontrate nga palet dhe pas noterizimit te saj nga une noterja, pala shitese, Shoqerite "ALKO-IMPEKS" sh.p.k. dhe "OTTO TIEFBAU GmbH & Co.", zhvishen nga pronesia e 59 % te kuotave ne shoqerine "OTTO-AL" sh.p.k. dhe pronar i ketyre kuotave dhe i te te gjitha kuotave te shoqerise "OTTO-AL" sh.p.k., behet zoti ISUF BERBERI, duke mbetur ortak i vetem dhe administrator i shoqerise "OTTO-AL" sh.p.k.

Pala shitesa deklaron se kuotat e mesiperme jane te lira dhe te zhveshura nga cdo detyrim ligjor dhe per cdo pretendim qe mund te ngrene te trete, ata jane te gatshem qe me kerkesen e bleresit te paraqiten para gjithe organeve gjygesore dhe administrative per te mbrojtur te drejten e tij si pronar i ligjshem i ketyre kuotave.

Palet deklarojne se te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga kjo kontrate shitblerje, jane realizuar midis tyre dhe nuk kane asnje pretendim lidhur me dorezimin dhe marrjen e kuotave. Qe nga ky moment palet nuk kane asnje detyrim ligjor dhe financiar ndaj njeri - tjetrit.

Kontrata u hartua ne perputhje me dispozitat e parashikuara nga Kodi Civil, nenet 705 dhe vijuesat e tij te ligjit "Per shoqerite Tregetare" dhe te akteve te Themelimit te shoqerise "OTTO-AL" sh.p.k.

Kontrata u hartua ne pese ekzemplare ne dy faqe me fuqi te barabarte, ne perputhje me nenin 51 te ligjit nr 7829 date 1.06.1994 "Per Noterine", ju lexua palese me ze te larte, te cilet e kuptuan permbajtjen e saj dhe meqenese ajo shpreh vullnetin e tyre, e nenshkruan ate perpara meje dhe une noterja, e vertetova ate sipas ligjit.

PALET KONTRAKTUESE

PALA SHITese

Per shoqerine "ALKO-IMPEKS" sh.p.k.



Ima Bekri
[Signature]

PALA BLERese

Isuf BERBERI

Isuf A. Berberi
[Signature]

Per shoqerine "OTTO TIEFBAU GmbH&Co."

Stephan Otto

[Signature]
Otto GmbH & Co.
TIEFBAU
33934 GRAZ

NOTERE

[Signature]
[Signature]